



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:208376
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05452555

C.nr.7566/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësve F. R. (PK...), Sh. Th. (PK...), B. Q. (PK...), B. M. (PK...), B. K. (PK...), të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Av. B. P. me seli në Vushtrri, Rruga “...” p.n., kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme, në Prishtinë, Rruga “Luan Haradinaj” p.n., të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti, kompensim i pagës së trembëdhjetë, shpërblimit jubilar dhe shujtave ditore, jashtë seancës gjyqësore me datë 11.03.2024, jep këtë:

A K T G J Y K I M
P a s h q y r t i m

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve F. R. (PK...), Sh. Th. (PK...), B. Q. (PK...), B. M. (PK...), B. K. (PK...), dhe DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, paditësve t’ua paguaj shumat si në vijim:

- Paditësit F. R. (PK...), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020, dhe 2021, t’ia paguaj për çdo vit shumën nga 620.24€, e në total, shumën prej 2,480.96€, si dhe në emër të kompesimit të një page jubilarë për përvojën e punës 11 vjeçare t’ia paguaj 25% të një page bazë me shumën prej 142.00€.

- Paditësit Sh. Th. (PK...), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t’ia paguaj për çdo vit shumën nga 531.90€, e në total, shumën prej 2.127.60€. si dhe në emër të kompesimit të një page jubilarë për përvojën e punës 21 vjeçare t’ia paguaj 50% të një page bazë me shumën prej 285.00€.

- Paditësit B. Q. (PK...), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t’ia paguaj për çdo vit shumën nga 580.24€, e në total, shumën prej 2,320.96€.

- Paditësit B. M. (PK...), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t’ia paguaj për çdo vit shumën nga 562.01€, e në total, shumën prej 2,248.04€.

- Paditësit B. K. (PK...), në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, t’ia paguaj për çdo vit shumën nga 502.50€, e në total, shumën prej 2,010.00€.

II. DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria Përgjithshme, në Prishtinë, Rruga “Luan Haradinaj” p.n., të ju paguaj paditësve F. R. (PK...), Sh. Th. (PK...), B. Q. (PK...), B. M. (PK...), B. K. (PK...), shumat e gjykuara si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % në vit, e cila fillon të llogaritet nga data 17.09.2021, dita kur është paraqitur padia në këtë gjykatë, e deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet e kësaj procedure kontestimore, 624.00€ për shpenzimet e angazhimit të avokatit lidhur me procesin gjyqësor dhe 101.00.00€ për taksën gjyqësore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes -pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

III. REFUZOHEN në tërësi kërkesat e paditësve, me të cilat kanë kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësve të ju paguaj në emër të shujtave ditore nga 3€ (tri), për çdo ditë të prezencës së paditësve në punë, për periudhën kohore 14.11.2018 e deri më datë 23.02.2022 apo për 740 ditë, të punës për secilin paditës, dhe atë për secilin veç e veç, nga 2,220.00€, si e pabazuar. dhe refuzohet kompensimi i pagesë jubilarë të paditësve, Sh. Th. për pervojën e punës 21 vjeqare t’ia paguaj 50% të një pagë bazë në shumen prej 285.00€, B. Q. për pervojën e punës 16 vjeqare t’ia paguaj 25% të një pagë bazë në shumen prej 142.00€, B. M. për pervojën e punës 17 vjeqare t’ia paguaj 25% të një pagë bazë në shumen prej 142.00€.

A r s y e t i m

Paditësit përmes përfaqësuesit të tyre, me datë 17.09.2021, kanë paraqitur padi dhe kërkesëpadi, kundër të paditurës, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, shpërblimit jubilar dhe shujtave ditore, pranë të cilës kanë mbetur edhe me parashtresën për precizim të datës 22.03.2022. Në padi paditësit kanë theksuar se duke marrë parasysh pervojën e paditësve në punë, kanë kërkuar nga e paditura, kompensimin e pagave jubilarë si dhe të pagave të trembëdhjeta, detyrime këto të cilat, burojnë nga Udhëzimi Administrativ mbi Marrëdhënien e punës në Polici nr. 02/2018 e datës 14.11.2018, por e njëjta nuk ju ka kthyer përgjigje.

Tutje ka kërkuar që paditësve të ju kompensohen shumat si në vijim:

Për paditësin F. R. (PK...), ka kërkuar që në emër të pagës së 13, të shpërblehet me një pagë të rregullt mujore, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nga 620.24€ për secilin vit, sa është paga mujore momentale, apo për katër vitet shumën prej 2,480.96€. Në emër të kompensimit të pagës jubilarë për pervojë të punës 11 vjeçare, të paguaj 25%, të një page bazë apo shumën prej 142.00€. Në emër të ushqimit – shujtave ditore ka kërkuar kompensim nga 3 euro në ditë, për periudhën e kohore 14.11.2018 – 23.02.2022, apo për 740 ditë të prezencës në punë, shumën prej 2,220.00€.

Për paditësin Sh. Th. (PK...), ka kërkuar që në emër të pagës së 13, të shpërblehet me një pagë të rregullt mujore, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nga 531.90€ për secilin vit, sa është paga mujore momentale, apo për katër vitet shumën prej 2,127.60€. Në emër të kompensimit të pagës jubilarë për pervojë të punës 21 vjeçare, të paguaj 50%, të një page bazë apo shumën prej 285.00€ Në emër të ushqimit – shujtave ditore ka kërkuar kompensim nga 3 euro në ditë, për periudhën e kohore 14.11.2018 – 23.02.2022, apo për 740 ditë të prezencës në punë, shumën prej 2,220.00€.

Për paditësin B. Q. (PK...), ka kërkuar që në emër të pagës së 13, të shpërblehet me një pagë të rregullt mujore, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nga 580.24€ për secilin vit, sa është paga mujore momentale, apo për katër vitet shumën prej 2,320.96€. Në emër të

kompensimit të pagës jubilarë për përvojë të punës 16 vjeçare, të paguaj 25%, të një page bazë apo shumën prej 142.00€. Në emër të ushqimit – shujtave ditore ka kërkuar kompensim nga 3 euro në ditë, për periudhën e kohore 14.11.2018 – 23.02.2022, apo për 740 ditë të prezencës në punë, shumën prej 2,220.00€.

Për paditësin B. M. (PK...), ka kërkuar që në emër të pagës së 13, të shpërblehet me një pagë të rregullt mujore, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nga 562.01€ për secilin vit, sa është paga mujore momentale, apo për katër vitet shumën prej 2,248.04€. Në emër të kompensimit të pagës jubilarë për përvojë të punës 17 vjeçare, të paguaj 25%, të një page bazë apo shumën prej 142.00€. Në emër të ushqimit – shujtave ditore ka kërkuar kompensim nga 3 euro në ditë, për periudhën e kohore 14.11.2018 – 23.02.2022, apo për 740 ditë të prezencës në punë, shumën prej 2,220.00€.

Për paditësin B. K. (PK...), ka kërkuar që në emër të pagës së 13, të shpërblehet me një pagë të rregullt mujore, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, nga 502.50€ për secilin vit, sa është paga mujore momentale, apo për katër vitet shumën prej 2,010.00€. Në emër të ushqimit – shujtave ditore ka kërkuar kompensim nga 3 euro në ditë, për periudhën e kohore 14.11.2018 – 23.02.2022, apo për 740 ditë të prezencës në punë, shumën prej 2,220.00 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8 % në vit, nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Me propozim për gjykatën që kërkesëpadia e paditësve të aprovet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura me datë 06.12.2022, ka parashtruar përgjigje në padi me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, duke deklaruar se se e kundërshton shumën e kërkuar në emër të kompensimit të pagës së fund vitit si dhe shujtës ditore, me arsyetimin pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ka shtuar se Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-125, neni 20 paragrafi 4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë, çdo nismë, duke përfshirë edhe atë lidhur me nenin 29 pika 2 të UA nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore – financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Më tej ka theksuar se kërkesëpadinë e paditësve lidhur me kompensimin e pagës së 13-të dhe shujtave për çdo vit kalendarik e kundërshtojmë pasi që këto vlejné vetëm në bazë të mundësive ligjore, financiare dhe institucionale të paditurës dhe asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh si detyrim, andaj e njëjta nuk mund të jetë obligim dhe detyrim i të paditurit. E paditura ndaj paditësit të vetmin detyrim ligjor e ka përmbushjen e Kontratës së Punës e cila konsiderohet ligj për palët Paditësi do të mund të kompensohet për pagën e 13-të dhe shujta, brenda mundësive institucionale ligjore dhe financiare” andaj deri më tani këto mundësi nuk janë krijuar, që nënkupton se nuk është detyrim për të paditurën. Duke i propozuar Gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për

dhënien e vendimit meritor, që në këtë rast rezulton se padia e paditësve është pjesërisht e bazuar për arsye se:

Me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: “Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”.

Ndërsa për pjesën tjetër të kërkesëpadisë, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 399 sipas të cilit “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: Në mes të palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimet e punësimit të bashkangjitura shkresave të lëndës për secilin paditës, të cilat janë të vitit 2021.

Nga vërtetimet e punësimit të cekura më lartë gjykata konstatoi se paditësi F. R., e ka filluar punën te e paditura nga data 23.04.2010, dhe realizon pagë mujore në shumë prej 620.24€, Paditësi Sh. Th. e ka filluar punën te e paditura nga data 19.06.2000, dhe realizon pagë mujore, në shumë prej 531.90€, Paditësi B. Q. e ka filluar punën te e paditura nga data 17.01.2005 dhe realizon pagë mujore, në shumë prej 580.24€, Paditësi B. M. ka filluar punën te e paditura nga data 14.06.2004, dhe realizon pagë mujore, në shumë prej 562.01€, Paditësi B. K. ka filluar punën te e paditura nga data 21.01.2019, dhe realizon pagë mujore, në shumë prej 502.50€.

Gjykata, vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 dhe UA nr.01/2021, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, për kërkesat e aprovuara të paditësve, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.

Me nenin 30 paragrafi 2 të UA nr.01/2021 përcaktohet se: “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”.

Sa i përket kërkesave të paditësve që kanë të bëjnë me kompensimin e shpërblimit jubilar në shkallën prej 25%, të pagës bazë, për çdo vit jubilar, për vitet 2018, 2019 dhe 2020, zbatohet neni 29 paragrafi 5 i UA nr.02/2018, në të cilin përcaktohet se: “Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Policinë e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë

prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite pune (paga jubilarë)”.

Ndërsa për kërkesat e paditësve që kanë të bëjnë me kompensimin e shpërblimit jubilar në shkallën prej 25%, të pagës bazë, për çdo vit jubilar, për vitin 2021, zbatohet neni 30 paragrafi 5 i UA nr.01/2021, në të cilin përcaktohet se: “Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Policinë e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite pune (paga jubilarë)”.

Nga interpretimi i dispozitave të lart cituara të Udhëzimeve Administrative 02/2018 dhe 01/2021, të nxjerra nga e paditura, dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar sepse paditësit e gëzojnë të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitojnë si shpërblim një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, në këtë rast paditësit, të kenë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës, nëse nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës. Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se të gjithë paditësit, kanë vlerësim të kënaqshëm, të performancës dhe të njëjtëve nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, për gjatë viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësve për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj ndonjërit prej paditësve.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021, dhe shpërblimet jubilarë në rastin konkret për paditësin, gjykata mori për bazë vërtetimet e punësimit, të vlerësuara si më lart, për secilin paditës veç e veç, e nga të cilat rezultojnë pagat të cilat i realizojnë paditësit, andaj të njëjtëve për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, iu takojnë secilit veç e veç shumat ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave të lart cituara, që të ua kompensoi paditësve, pagat e 13-ta, për fund vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021, dhe shpërblimet jubilarë për çdo 10 vite përvojë pune, në rastin konkret për paditësin e parë dhe të dytin. Andaj paditësit e kanë cilësinë e kreditorëve ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin përcaktohet se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitorit ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura ju ka mbetur borxh paditësve me aplikimin e dispozitave të lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve të ju kompensoi shumat e gjykuara, si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 22.06.2021, dita e paraqitjes së kërkesëpadiisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Gjykata i ka refuzuar në tërësi kërkesat e paditësve për kompensimin e shujtave ditore për gjithsej 740 ditë pune për periudhën kohore nga data 14.11.2018 e deri me 23.02.2022, apo në shumën prej 2,220.00 €, për secilin paditës, sepse me paragrafin 1 të nenit 29 të UA nr.02/2018 si dhe të nenit 30 paragrafi 1 të UA nr.01 /2021, përcaktohet se: “Paga bazë, shtesat

për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”. Pasi që dispozitat ligjore të lart cituar nuk e detyrojnë shprehimisht të paditurën për kompensimin e shujtave ditore ashtu siç kanë kërkuara paditësit, andaj vendosi si në pikën -III-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendim se detyrimet financiare nga Udhëzimi Administrativ, se nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast Udhëzimet Administrative të lartcekura, janë aprovuar nga struktura të larta të të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuara, nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësve duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat e lartcekura për derisa e paditura me asnjë provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësit, për pjesën e aprovuar të kërkesës.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata është në dispozitën nenit 449 dhe 452 e LPK-së, sipas të cilave paditësve ju pranohen shpenzimet në shumën totale prej 624.00€ për shpenzimet e angazhimit të avokatit lidhur me procesin gjyqësor dhe 100.00€ për taksën gjyqësore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes - pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtrësë të deponuar.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.7566/21 datë 11.03.2024

Gjyqtari
Përparim Zeka

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.